



REPUBLIKA E KOSOVËS - PRESIDENTI
REPUBLIC OF KOSOVO - THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO - PRESEDNIK

DEKRET PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRKOMBËTARE

Nr. i Dekretit: DMN – 016 – 2018

Presidenti i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 18 dhe 84 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 6 të Ligjit Nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës (GZ, Nr. 47, 25 janar 2009), nenit 10 (4) të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare (GZ, Nr. 28, 16 dhjetor 2011), nenit 4 (3) të Ligjit Nr. 03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës (GZ, Nr. 26, 02 qershor 2008), si dhe duke marrë parasysh kërkesën e Ministrisë së Punëve të Jashtme drejtuar Presidentit, më datën 04.09.2018 (Nr. Prot:1009):

D E K R E T O N

Ratifikimin e Marrëveshjes mbi Transportin Ndërkombëtar Rrugor të Udhëtarëve dhe Mallrave, e nënshkruar në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Malit të Zi, më 08.08.2018 dhe e pranuar nga Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës, më 04.09.2018.

Marrëveshja e ratifikuar i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për njoftim, në përputhje me nenin 18, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Hashim THAÇI

President i Republikës së Kosovës

Prishtinë, më 18.09.2018

Dekreti t'i dërgohet:

- Kryetarit të Kuvendit të Kosovës;
- Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme;
- a/a.



MARRËVESHJE
NDËRMJET
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS
DHE
QEVERISË SË MALIT TË ZI
MBI TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR RRUGOR
TË UDHËTARËVE DHE MALLRAVE

Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Qeveria e Malit të Zi, këtu e tutje të përmendura si “Palë Kontraktuese”;

Me dëshirën për të kontribuar për zhvillimin e marrëdhënieve tregtare dhe ekonomike ndërmjet dy shteteve;

Të vendosur për të nxitur bashkëpunimin e transportit ndërkombëtar rrugor në kuadër të ekonomisë së tregut;

Të shqetësuar për mbrojtjen e mjedisit dhe njerëzve, përdorimin racional të energjisë, sigurinë në rrugë dhe përmirësimin e kushteve të punës së drejtuesve të automjeteve;

Të prirur për zhvillimin e transportit intermodal;

Duke marrë parasysh rezolutat dhe parimet e miratuara brenda kornizës të Komisionit Ekonomik të Kombeve të Bashkuara për Evropën, Forumit ndërkombëtar për Transport (ITF), Konferencës Pan-Evropiane dhe marrëveshjet ndërmjet Bashkimit Evropian dhe vendeve të treta;

Njohjen e interesit të ndërsjellë dhe të përfitojnë nga një marrëveshje mbi transportin rrugor ndërkombëtar;

Kanë rënë dakord si vijon:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

1. Kjo Marrëveshje rregullon transportin rrugor ndërkombëtar të udhëtarëve dhe mallrave të kryera nga operatorët e transportit të themeluara në territorin e njëres Palë Kontraktuese me automjete të regjistruara në atë territor me pikënisje në territorin e njëres palë kontraktuese dhe me destinim në territorin e palës tjetër kontraktuese, transit përmes njërit territor të palëve kontraktuese ose operimet e transportit për nga vendet e treta.
2. Kjo Marrëveshje nuk ndikon të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet të tjera ndërkombëtare që kanë firmosur Palët Kontraktuese.

Neni 2 Përkufizime

Termat e përdorur në këtë Marrëveshje kanë kuptimet e mëposhtme:

1. "Operator transportit" nënkupton çdo person fizik ose juridik, të autorizuar për të kryer transport ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve dhe mallrave, në përputhje me rregulloret e palëve kontraktuese në territorin e së cilës është themeluar.
2. "Mjet" nënkupton një mjet motorik ose kombinim mjetesh, të regjistruar në territorin e njërës nga Palët Kontraktuese, me qëllim të kryerjes së transportit rrugor ndërkombëtar të udhëtarëve dhe mallrave, në dispozicion të operatorit të transportit qoftë në pronë të tij, apo përmes një kontrate të qiramarrjes apo lizingut të licencuar/certifikuar bazuar në legjislacionin kombëtar të palëve kontraktuese.
3. "Transport" nënkupton operimet e mjetit me udhëtarë apo mallra, ose operimet e mjetit pa ngarkesë, duke përfshirë transportin e mjetit me tren apo anije për një pjesë të udhëtimit.
4. "Kabotazhi" nënkupton transportin e udhëtarëve apo mallrave në mes të pikave brenda territorit të njërës palë kontraktuese, i cili kryhet nga operatori i transportit i themeluar në territorin e palës tjetër kontraktuese.
5. "Transporti i kombinuar" nënkupton transportin e mallrave me kamion, rimorkio, gjysmë-rimorkio, me ndonjë mjet tjetër zëvendësues apo kontejner, me apo pa automjet për tërheqje, që qarkullojnë vetëm në segmentin fillestar apo përfundimtar të rrugës, i cili duhet të jetë sa më i shkurtër, ndërsa në segmentin kryesor të rrugës transportohen me tren, rrugës së brendshme lumore apo detare.
6. "Territori i njërës Palë Kontraktuese" nënkupton përkatësisht territorin e Republikës së Kosovës dhe territorin e Malit të Zi.
7. "Vendi i themelimit" nënkupton territorin e Palës Kontraktuese në të cilin është themeluar operatori i transportit dhe mjeti motorik është i regjistruar.
8. "Vendi pritës" nënkupton territorin e një Pale Kontraktuese në të cilin një operator transporti operon pa pasur të regjistruar automjetin atje dhe pa qenë i themeluar atje.
9. "Autoriteti kompetent" në rastin e Malit të Zi nënkupton Ministria e Transportit dhe Detarisë, si dhe në rastin e Republikës së Kosovës Ministria e Infrastrukturës përkatësisht Organi kompetent për transport rrugor.
10. "Shërbimi i rregullt i udhëtarëve" nënkupton një shërbim, ku udhëtarët transportohen përgjatë itinerareve të specifikuara, bazuar në rend të udhëtimit dhe çmimore e cila duhet të përcaktohet dhe publikohet paraprakisht ku udhëtarët hipin ose zbresin në vend-ndaljet të paracaktuara më parë.
11. "Shërbimi vajtje-ardhje" do të thotë shërbimi ku me anë të udhëtimeve shkuese dhe kthyes në mënyrë të përsëritur, grupe udhëtarësh paraprakisht të formuara transportohen nga vendi i nisjes deri në vendin e destinacionit. Vendi i nisjes dhe i destinacionit përkatësisht do të thotë vendi ku udhëtimi fillon dhe vendi ku udhëtimi përfundon, së bashku me lokacionin që e rrethon përbrenda radiusit prej 25 km. Secili grup që është pjesë e udhëtarëve të cilët kanë udhëtuar në shkuarje transportohen mbropa në vendin e nisjes në një udhëtim të mëvonshëm.

Shërbimi vajtje-ardhje nuk është ndikuar nga fakti se disa udhëtarë i bashkëngjiten një grupi tjetër në udhëtimin e tyre në kthim. Udhëtimi i parë në kthim dhe udhëtimi i fundit në shkuarje në një seri të vajtje-ardhjeve zhvillohen të zbrazët.

12. "Shërbimet e rastit" nënkuptojnë shërbimet të cilat nuk përkojnë me përkufizimin e shërbimeve të rregullta, as në shërbimet vajtje-ardhje, ku frekuenca apo numri i shërbimeve nuk ndikon në klasifikimin e tyre si shërbimet e rastit.
13. "Dokumenti i kontrollit" në rast të kryerjes së shërbimeve të rastit ose shërbimeve vajtje-ardhje për transportin e udhëtarëve nënkupton libri i udhëtarëve siç është e përshkruar në marrëveshjen INTERBUS.
14. "Komiteti i përbashkët" është i themeluar nga autoritetet e palëve kontraktuese për qëllim të implementimit dhe obligimeve që rrjedhin nga kjo marrëveshje.

II. TRANSPORTI I UDHËTARËVE

Neni 3

Shërbimet e rregullta

1. Shërbimet e rregullta të udhëtarëve do të nënshtrohen sistemit të autorizimeve të lëshuara nga autoritetet kompetente në vendin e nisjes, destinacionit dhe transitit.
2. Aplikimi për lëshimin e autorizimit duke ju referuar paragrafit 1 të këtij neni duhet të drejtohet autoritetit kompetent të vendit të themelimit të operatorit të transportit. Nëse autoriteti kompetent i vendit të themelimit aprovon kërkesën, ajo i komunikohet autoritetit kompetent të palës kontraktuese për aprovim. Autorizimi lëshohet atëherë kur merret aprovimi nga të dy palët kontraktuese.
3. Vendimi për të dhënë ose refuzuar lëshimin e autorizimit merret nga Autoritetet Kompetente të palëve kontraktuese në periudhë prej 90 ditësh nga dita e dorëzimit aplikacionit nga autoriteti kompetent i vendit të themelimit, me përjashtim të rrethanave të paparashikueshme.

Në rast të rrethanave të paparashikueshme, ky afat mund të ndryshohet dhe për të cilën Autoritetet Kompetente informojnë njëra tjetrën.

Autorizimet e referuara në pikën 2 të këtij neni janë të vlefshme maksimum pesë (5) vite. Ato përcaktojnë kushtet e operimit për kryerjen e shërbimeve të rregullta të udhëtarëve.

4. Ndryshimet e kushteve operuese dhe anulimi i shërbimit vendoset sipas procedurave të përcaktuara në pikat 2 dhe 3, të këtij neni.
5. Për çdo veprim të ndërmarrë nga ana e Autoriteteve Kontraktuese, që ka të bëjë me transportin e rregullt ndërkombëtar të udhëtarëve, palët kontraktuese janë të obliguar që të informojnë njëra tjetrën.

Komiteti i Përbashkët mund të parashoh kritere shtesë për masa të përbashkëta deri në anulimin lejes/autorizimit.

6. Komiteti i përbashkët, vendosë për afatet, procedurat, formën e aplikimit për autorizim, si dhe dokumentet tjera mbështetëse.

Neni 4

Shërbimet vajtje-ardhje dhe të rastit

1. Shërbimet vajtje-ardhje dhe të rastit për transportin e udhëtarëve me autobus i nënshtrohen sistemit të autorizimeve të lëshuara nga autoritetet kompetente në vendin e nisjes dhe destinacionit.
2. Përjashtimisht nga dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni, shërbimet e rënditura në marrëveshjen INTERBUS janë të përjashtuara nga autorizimet.
3. Marrja dhe zbritja e udhëtarëve gjatë një udhëtimi referuar paragrafit 1 të këtij neni nuk është e lejuar.
4. Palët kontraktuese shkëmbejnë “kuotën” numrin e autorizimeve të përcaktuara në këtë nen, dhe të njëjtat lëshohen nga autoriteti kompetent në vendin e themelimit.
5. Komiteti i Përbashkët vendos për “kuotat” numrin e autorizimeve, formën, përmbajtjen, vlefshmërinë dhe kushtet e operimit të autorizimit të referuara në paragrafin 1 të këtij neni, dhe për të cilat do të shkëmbejnë formën e aplikimit dhe dokumenteve tjera të kërkuara.
6. Gjatë zhvillimit të shërbimeve të transportit të udhëtarëve operatori i transportit është i obliguar që dokumentet e kontrollit në origjinal ti posedoj në automjet.

Neni 5

Dispozitat e përbashkëta për shërbimet e udhëtarëve

1. Autorizimet e transportit referuar sipas nenit 3 dhe 4, janë personale dhe nuk mund të transferohen për operatorët tjerë të transportit, dhe duhet të jenë në origjinal në automjet, përgjatë gjithë udhëtimit.
2. Zhvillimi i shërbimit të kabotazhës është i ndaluar. Udhëtimet lokale të organizuara vetëm për një grup të udhëtarëve që sjellen në atë lokacion nga i njëjti operator i transportit dhe që nuk cilësohen si shërbime të kabotazhës me kusht që ata të futen në listën e udhëtarëve.

III. TRANSPORTI I MALLËRAVE

Neni 6

1. Operatori i Transportit i njëjës palë kontraktuese ka të drejt të kryej transport rrugor ndërkombëtar të mallrave, dhe mund të kryej transport të tillë ndërmjet territoreve, të dyja palëve kontraktuese, në transit nëpër këto territorie e njëjës palë pa leje.

2. Transporti i mallrave për/nga vendet e treta i nënshtrohet sistemit të lejeve.
3. Leja nuk mund të transferohet dhe mund të shfrytëzohet nga transportuesi në emër të të cilit është lëshuar.
4. Komiteti i Përbashkët mund të pajtohet që autoritetet kompetente të palëve kontraktuese për shkëmbimin të një numri të caktuar të lejeve për kryerjen e transportit për/nga territoret e tyre për në vendet e treta në ndërkohë. Komiteti i përbashkët ka të drejt të përjashtoj nga sistemi i lejeve disa lloje të caktuara të transportit deri në liberalizim të plotë.

Neni 7

Kabotazhi

Operatori i Transportit me vend qëndrim të përhershëm në territorin e njëjës palë kontraktuese nuk mund të kryej shërbime të transportit ndërmjet dy pikave të territorit të palës tjetër kontraktuese, përveç me autorizim të veçantë për këtë qëllim të lëshuar nga autoriteti kompetent i Palës tjetër kontraktuese.

IV. DISPOZITAT E PËRBASHKËTA

Neni 8

Taksat, detyrimet dhe tarifat tjera

1. Operatori i Transportit i regjistruar në territorin e njëjës palë kontraktuese dhe i cili përkohësisht operon në territorin e palës tjetër kontraktuese në pajtim me dispozitat e kësaj marrëveshje janë të përjashtuara, sipas parimit të reciprocitetit, nga pagesat dhe të gjitha taksat, tarifat lidhur me pronësinë, regjistrimin dhe operimin e automjetit.
2. Karburanti i vendosur në depozitat normale të mjetit të ndërtuar nga prodhuesi për këtë qëllim dhe që përdoret për funksionimin e mjetit ose për funksionimin e pajisjeve në temperaturën e kontrolluar, ashtu si dhe për lubrifikantët dhe pjesët rezervë janë të përjashtuara nga të gjitha detyrimet e importit në territorin e vendit pritës, bazuar në legjislacionin e palëve kontraktuese.
3. Shërbimet e transportit të mbuluara nga dispozitat e kësaj marrëveshje i nënshtrohen taksave rrugore, tarifa dhe detyrimet tjera të vëna për shfrytëzim të rrjeteve rrugore, urave, tuneleve etj. në vendin pritës. Tarifat dhe taksat e vëna për shfrytëzim të rrugës për operatorët vendor dhe të huaj nuk do jenë diskriminuese.
4. Komiteti i përbashkët mund që në pajtim me parimin e reciprocitetit të vendos të lirojnë operatorët transportues të palëve kontraktuese nga pagesat për shfrytëzimin e rrugëve.

Neni 9
Pesha dhe përmasat e mjetit

1. Pesha maksimale e lejuar, pesha për akset dhe dimensionet e mjeteve nuk duhet të kalojnë ato të shënuara në dokumentet e regjistrimit dhe as në kufijtë e vlerave më të lartë të lejueshme në fuqi në vendin pritës.
2. Përdorimi i mjeteve, pesha dhe përmasat e të cilave i kalojnë kufijtë maksimalë të lejueshëm, lejohet në vendin pritës vetëm me leje (autorizim) të veçantë të lëshuar nga autoritetet kompetente të vendit pritës, duke aplikuar paraprakisht për këtë.

Neni 10
Pajisjet dhe karakteristikat e tjera të mjeteve

1. Mjetet të cilat transportojnë mallra të rrezikshme dhe mallra që prishen lehtë duhet të jenë të pajisura në pajtim me rregulloret ndërkombëtare.
2. Pajisjet që përdoren për monitorimin e ekuipazhit për kohën e ngasjes dhe pushimit duhet të jenë në përputhje me rregulloret ndërkombëtare.
3. Palët kontraktuese ndërmarrin veprime për të promovuar brenda kornizës të kësaj marrëveshjeje, përdorimin e automjeteve të sigurta dhe emetimin e gazrave sipas standardeve, në pajtim me rregulloret e BE-së në lidhje me këtë fushë dhe të njëjtat zbatohen në pajtim me obligimet ndërkombëtare të marrura përsipër.

Neni 11
Kontrolli

Lejet dhe dokumentet tjera të parashikuara në bazë të kësaj marrëveshjeje, si dhe në bazë të marrëveshjeve shumëpalëshe në të cilat të dyja palët kontraktuese janë Palë, ose sipas legjislacionit kombëtar duhet të mbahen në mjet dhe t'i prezantohen zyrtarëve të kontrollit të autorizuar të palëve kontraktuese.

Neni 12
Detyrimet e operatorëve të transportit dhe shkeljet

1. Transportuesit e palës kontraktuese, gjatë qëndrimit në territorin shtetërorë të palës tjetër kontraktuese, janë të obliguar t'i respektojnë detyrimet që dalin nga marrëveshjet shumëpalëshe ndërkombëtare në të cilat palët kontraktuese janë gjithashtu palë, si dhe nga marrëveshjet tjera bilaterale dhe ato nga legjislacioni nacional, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me qarkullimin dhe kundërvajtjen, dispozitat doganore dhe kushtet tjera të lejes dhe kufizimet.
2. Në rast të çfarëdo shkeljeje të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje nga transportuesi, organi kompetent i shtetit pritës e njofton për këtë organin kompetent të shtetit të

themelimit me qëllim që ai autoritet të marrë masa të nevojshme kundër transportuesit, siç është paraparë me legjislacionin e tij kombëtar.

3. Dispozitat e paragrafit 2. të këtij neni nuk i përjashtojnë masat që i marrin autoritetet gjyqësore, apo autoritetet tjera kompetente të shtetit pritës.
4. Në rast të përsëritjes së kundërvajtjeve të rënda, të bëra në territorin e vendit pritës, autoriteti kompetent i shtetit pritës mund t' i ndërmarrë vetë, apo me kërkesë të autoritetit kompetent të shtetit të themelimit këto veprime:
 - a. t' i japë vërejtje transportuesit;
 - b. t' ia ndalojë çasjen në territorin e palës kontraktuese ku është bërë kundërvajtja.
5. Autoritetet kompetente të Palëve kontraktuese e gjithmonë do të informojnë njëra-tjetrën për sanksionet e shqiptuara nga paragrafi 4. të këtij neni.

Neni 13

Bashkëpunimi dhe Komiteti i përbashkët

1. Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese janë të obliguar të ndërmarrin hapa të nevojshëm për zbatimin e kësaj marrëveshje dhe të njoftojnë njëra tjetrën për informacion të dobishëm dhe për çdo ndryshim në legjislacionin kombëtar në fushën e transportit rrugor.
2. Autoritetet kompetente do të krijojnë komitetin e përbashkët me qëllim të zbatimit të kësaj marrëveshje dhe shqyrtimin e të gjitha pyetjeve në lidhje me palët kontraktuese në fushën e transportit rrugor, duke përfshirë sigurinë, dokumentet personale të ngasësit si dhe dokumentet e mjetit, mbrojtjen e mjedisit, ekuipazhin e mjetit, çështjet teknike, promovimin e ndërmarrjeve nga fusha e transportit rrugor, bashkëpunimin reciprok dhe zgjedhjen e çështjeve diskutabile.
3. Me kërkesë të njërës Palë Kontraktuese, Komiteti i përbashkët do të takohet së paku një herë në vit.

V. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 14

Hyrja në fuqi dhe vlefshmëria e Marrëveshjes

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi 30 ditë pas marrjes së njoftimit të fundit me shkrim përmes kanaleve diplomatike dhe për të cilat Palët Kontraktuese njoftojnë njëra tjetrën që procedurat për hyrjen e saj në fuqi në përputhje me legjislacionin kombëtar janë përfunduar.

2. Kjo Marrëveshje mbetet në fuqi për një periudhë kohore të pacaktuar, përveç nëse nuk anulohet me anë të një njoftimi me shkrim përmes kanaleve diplomatike nga njëra palë kontraktuese. Me këtë rast vlefshmëria e kësaj marrëveshje merr fund gjashtë muaj pasi që palët kontraktuese të pranojnë njoftimin e lartcekur.

Në dëshmi të kësaj të nënshkruarit, duke qenë të autorizuar nga Qeveritë respektive, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë në **Podgoricë**, më **1 gusht 2018**, në dy kopje origjinale në gjuhën shqipe, malazeze, serbe dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njësoj autentike.

Në rast të mosmarrëveshjeve ose divergjencave në interpretimin e kësaj marrëveshje, do të mbizotëroj teksti në gjuhën angleze.

Për Qeverinë e Republikës së Kosovës



Pal LEKAJ
Ministër i Infrastrukturës

Për Qeverinë e Malit të Zi



Osman NURKOVIĆ
Ministër i Transportit dhe Çështjeve
Detare